



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË

Nr. 2395 prot.

Libohovë më, 05.12 2024

NJOFTIM PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Titulli dhe kodë i projektaktit:

Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, miratimi Paketës Fiskale dhe planifikimi për buxhetin e vitit 2025, Bashkia Libohovë.

Takimi publik:

Konsultimet publike do të organizohen sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.

Të ftuar:


Të gjithë banorët e territorit të Bashkisë Libohovë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi, OJF, Media, Kryetarët e Fshatrave dhe grupe vulnerabël, përfaqësues të shoqatës së personave me aftësi të kufizuar etj.

Pjesëmarrës nga bashkia:

Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Nënkryetarët, Sektori i Financës, Administratorët e Njësive Administrative, Sekretarja e Këshillit Bashkiak, Koordinatorin për informim dhe Konsultimin Publik, Këshilltarë të Këshillit Bashkiak.

Drejtuesi i takimit publik:

Kryetari i Bashkisë Libohovë z. Leonard Hide

Informacioni për publikun	Përshkrim
 <p>1 Qëllimi i këshillimit publik.</p>	<p>Nëpërmjet konsultimit dhe bashkëbisedimit me banorët dhe grupet e synuara Bashkia Libohovë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve dhe rekomandimeve nga komuniteti lidhur me Paketën Fiskale dhe Planifikimin e Buxhetit për vitin 2025, miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.</p>
<p>2 Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti.</p>	<p>Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 18, dhe nenit 54 shkonja “e” të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, si dhe në zbatim të ligjit 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në ligjin 68/2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik” Këshilli Bashkiak Libohovë do të organizojë seanca këshillimi dhe dëgjimi me qytetarët për diskutimin e Paketës Fiskale planifikimin e buxhetit për vitin 2025, programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, Bashkia Libohovë.</p>
<p>3 Projekt-akti dhe relacionin shoqërues</p>	<p>Materiali i ngarkuar në www.bashkialibohove.gov.al</p>
<p>4 Pyetjet që i drejtohen publikut</p>	<p>A mendoni se prioritetet e parashikuara në këtë draft Program janë në përputhje me ato që ju konsideroni prioritate? Cilat janë sugjerimet tuaja për të përmirësuar/ndryshuar këtë draft Program? Cfarë konsideroni se duhet shtuar në këtë draft Program?</p>
<p>5 Grupet e interesit, strukturat komunitare me të cilat do të konsultohet projekt-akti</p>	<p>Banorë të Bashkisë Libohovë dhe Njësive Administrative.</p>
<p>6 Nj.A, Lagjet, Fshatrat ku do të mbahen takimet publike apo që ftohen të dërgojnë komente dhe rekomandime.</p>	<p>Bashkia Libohovë, sipas kalendarit bashkëlidhur.</p>



7	Kalendari i takimeve dhe dëgjësave publike	Kalendari i datave, vendeve dhe orëve është i përcaktuar në kalendarin bashkëlidhur këtij njoftimi. Për cdo lloj komunikimi jeni të lutur të kontaktoni nëpërmjet e-mailit: www.bashkialibohove.gov.al
8	Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve	1. Komentet dhe rekomandimet tuaja i mirëpresim brenda datës 15/12/2024: 2. Nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj në takimin publik, apo mund t'i dërgoni me e-mail në adresën: rahimskenderi@yahoo.com Info@bashkialibohove.gov.al ose nëpërmjet postës në adresën: Bashkia Libohovë, rruga Avni Rustemi, Lagja Linua”; Kodi postar: 6003 www.bashkialibohove.gov.al
9	Çfarë do të vijojë pas kësaj faze këshillimi.	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, Kryetari i Bashkisë dhe drejtoritë përkatëse do të përmbledhin informacionin dhe caktojnë prioritetet e Buxhetit 2025 dhe Paketës Fiskale, me të gjitha rekomandimet e nxjerra nga këto dëgjësja publike.

Kalendari i zhvillimit të konsultimeve publike me qytetarët e Bashkisë Libohovë.

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	Zagorie	10.12.2024	11:00	Sheper
2	Qendër Libohovë	11.12.2024	17:00	Nepravishtë
3	Qendër Libohovë	12.12.2024	17:00	Shtëpia Kulturës Libohovë

Koordinator Per Njoftimin
Dhe Konsultimin Publik: Daniela Hila

Daniela.Hila@bashkialibohov.gov.al